



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedn. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	147
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	07.06.2017
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr. 01/147/2017

Datë: 01/06/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e tretë të përbërjes së parë, të mbajtur më 01 qershor 2017, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

*Aleksandër Lumezi*  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Anëtarëve të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë  
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë / Akademiya Pravde / Academy of Justice*

---

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1, dhe në pajtim me nenin 11 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 01.06.2017,

Miraton:

**RREGULLORE NR. 02/2017**  
**PËR PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra, organizimi i punës, vendimmarrja dhe funksionimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga Akademia e Drejtësisë /Këshilli për qëllimet e përcaktuara me këtë Rregullore.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1 “Akademia” nënkupton Akademinë e Drejtësisë;

1.2 “Këshilli” nënkupton Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;



- 1.3 “Drejtori” nënkupton Drejtorin Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- 1.4 “Kryesuesi” nënkupton Kryesuesin e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- 1.5 “Zëvendës Kryesuesi” nënkupton Zëvendës Kryesuesin e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;

#### **Neni 4**

#### **Parimet bazë të punës së Këshillit**

Këshilli në punën e tij udhëhiqet nga parimet e pavarësisë, profesionalizmit dhe transparencës.

#### **Neni 5**

#### **Gjuha e punës**

Gjuhë e punës së Këshillit, është gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

#### **Neni 6**

#### **Kompetencat e Këshillit**

1. Kompetencat e Këshillit të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit nr.05/L - 095 për Akademinë e Drejtësisë, janë si në vijim:

- 1.1. miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- 1.2. miratimi i projektbuxhetit të Akademisë;
- 1.3. miratimi i strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- 1.4. miratimi i listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- 1.5. mbikëqyrja e punës së Akademisë;
- 1.6. përcaktimi i prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- 1.7. zgjedhja dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv;
- 1.8. emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Programor;
- 1.9. kryerja e punëve të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

#### **Neni 7**

#### **Përbërja e Këshillit**

1. Përbërja e Këshillit është përcaktuar me nenin 8 të Ligjit për Akademinë.

#### **Neni 8**

#### **Kryesuesi i Këshillit**

1. Kryesuesi i Këshillit zgjedhet nga anëtarët e Këshillit në pajtim me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe ka këto kompetenca:

- 1.1. Përfaqëson Këshillin para publikut dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- 1.2. Kujdeset për organizimin dhe menaxhimin e punës së Këshillit;
- 1.3. Thërret dhe kryeson mbledhjet e Këshillit;
- 1.4. Propozon (përcakton) rendin e ditës në bashkëpunim me Drejtorin;
- 1.5. Udhëheq punën e Këshillit;
- 1.6. Së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, kujdeset për zbatimin e akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli;
- 1.7. Nënshkruan aktet në emër të Këshillit;
- 1.8. Mbikëqyrë punën e Komisioneve të themeluara nga Këshilli;
- 1.9. Kryesuesi kryen punë dhe detyra të tjera të caktuara me ligj, me këtë rregullore dhe me dispozita tjera ligjore.

### **Neni 9** **Zëvendës Kryesuesi i Këshillit**

Zëvendës Kryesuesi i Këshillit e zëvendëson Kryesuesin në mungesë të tij dhe i ndihmon Kryesuesit në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.

### **Neni 10** **Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit**

1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit bëhet mundësisht në mbledhjen e parë themeluese të Këshillit;
  - 1.1 pas skadimit të mandatit;
  - 1.2 pas shkarkimit; apo
  - 1.3 ndonjë rrethane tjetër e cila e bën të pamundshme ushtrimin e funksionit të Kryesuesit dhe/apo Zëvendës Kryesuesit;
2. Procedura për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 e këtij neni iniciohet së paku 30 ditë para përfundimit të mandatit të rregullt, ndërsa për rastet tjera sa më parë që të jetë e mundur.
3. Mënyra e votimit për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit përcaktohet me vendim nga Këshilli.
4. Nëse dështon zgjedhja e një kandidati të propozuar për Kryesues apo Zëvendës Kryesues, ai nuk mund të propozohet më shumë se dy herë për tu votuar.
5. Mbledhjen në të cilën zgjidhet Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi, në mungesë të Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit, e udhëheq anëtari i Këshillit, më i vjetër në moshë.

### **Neni 11** **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Këshillit**

1. Anëtarët e Këshillit kanë këto të drejta dhe detyra:



- 1.1. Të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, përveç mungesave të arsyetuara, me ç'rast janë të detyruar që paraprakisht ta njoftojnë Kryesuesin e Këshillit;
- 1.2. Të marrin pjesë në punën e komisioneve dhe grupeve të formuara nga Këshilli;
- 1.3. Të marrin pjesë në shqyrtim sipas rendit të ditës dhe të votojnë sipas bindjes së vet për çdo çështje e cila shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit;
- 1.4. Të ruajnë dhe të mos zbulojnë sekretin e informacionit për punën e tyre në pajtim me dispozitat e ligjit përkatës për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.
- 1.5. Të evitojnë gjatë vendimmarrjes njëanshmërinë, konfliktin e interesit apo diskriminimin mbi çfarëdo bazë.
- 1.6. Të kryejnë detyrat tjera të caktuara nga ana e Këshillit;

## **Neni 12**

### **Themelimi i komisioneve**

1. Këshilli sipas nevojës mund të themelojë komisione të veçanta që do ta ndihmonin në ushtrimin e kompetencave përkatëse.
2. Këshilli me vendim e cakton përbërjen e komisionit, përshkrimin e shkurtër të detyrave, të drejtave dhe mënyrën e punës. Kryesuesi i komisionit të veçantë është anëtar i Këshillit.
3. Në punën e komisioneve të veçanta merr pjesë edhe përfaqësuesi i Akademisë së Drejtësisë.
4. Anëtarët e komisioneve, me përjashtim të anëtarëve të Këshillit kanë të drejtë në kompensim financiar me shumën e përcaktuar nga Këshilli.

## **Neni 13**

### **Mbështetja Administrative Teknike**

Stafi administrativ i Akademisë së Drejtësisë, i ofron mbështetje administrative dhe teknike Këshillit, si dhe komisioneve të veçanta të themeluara nga Këshilli.

## **Neni 14**

### **Mbledhjet e Këshillit**

1. Këshilli kryen punët nga kompetenca e tij në mbledhje.
2. Mbledhjet e rregullta të Këshillit mbahen së paku katër (4) herë në vit, çdo tre muaj nëse janë prezent më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
3. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit thirren nga Kryesuesi, përveç rasteve kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit ose me propozimin arsyetuar me shkrim të Drejtorit.

## **Neni 15**

### **Njoftimi për mbledhjet e Këshillit**

1. Mbledhjen e Këshillit e thërret Kryesuesi sipas iniciativës së vet apo me propozimin e së paku të një të tretës (1/3) së anëtarëve të Këshillit ose me propozimin e arsyetuar me shkrim të Drejtorit.
2. Njoftimin për mbledhjet e rregullta dërgohet me postë elektronike (e-mail) ose shkresë të dërguar përmes Zyrës së Drejtorit, së paku pesë (5) ditë pune para mbledhjes.
3. Në rast të mbledhjeve të jashtëzakonshme, Këshilli mund të njoftohet, me telefon, postë elektronike, ose në mënyrë tjetër më së voni 24 orë para mbajtjes së mbledhjes.

## **Neni 16**

### **Rrjedha e Mbledhjes së Këshillit**

1. Kryesuesi e hap mbledhjen e Këshillit, vërteton se a ekziston shumica e nevojshme për punë prej 5 anëtarëve (kuorumi) dhe informon, se cilët anëtarë kanë paralajmëruar dhe arsyetuar mungesën.
2. Nëse nuk janë të pranishëm shumica e nevojshme e anëtarëve, Këshilli mundet në një mbledhje të radhës të thirrur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë më vonë, të nxjerrë vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, por, vetëm nëse agjenda e takimit u është dërguar të gjithë anëtarëve të Këshillit.
3. Pasi që Kryesuesi e hap mbledhjen, vërtetohet rendi i ditës. Çdo anëtar i Këshillit mund të kërkojë që rendi i ditës të ndryshohet apo të plotësohet, por atë propozim duhet t'a arsyetojë. Kryesuesi e vë në votim propozimin e ndryshuar apo të plotësuar të rendit të ditës.
4. Rendi i ditës miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në takim.

## **Neni 17**

### **Marrja e vendimeve**

1. Këshilli merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.
2. Vendimet e Këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
3. Të gjitha çështjet për të cilat vendos Këshilli, përfshihen në procesverbalin e mbledhjes, i cili miratohet në njërin nga mbledhjet e radhës të Këshillit, nënshkruhet nga Kryesuesi.
4. Vendimet e Këshillit publikohen në faqen zyrtare të Akademisë me përjashtim të vendimeve që klasifikohen si konfidenciale.

## **Neni 18**

### **Procesverbali i takimit**

1. Për punën e Këshillit, në mbledhje mbahet procesverbali.



2. Procesverbalin e mban zyrtari kompetent i caktuar nga Drejtori.
3. Procesverbali përmban të dhënat themelore, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, numrin e mbledhjes, pjesëmarrësit, personat e tjerë që prezantojnë, emrin e udhëheqësit, rendin e përcaktuar të ditës, emrat e paraqitësve dhe pjesëmarrësve në diskutim dhe vendimet e marra sipas pikave të rendit të ditës dhe çështjet tjera me rëndësi.
4. Gjatë mbledhjes së Këshillit mund të incizohen audio nga zyrtari kompetent.
5. Procesverbali u dërgohet të gjithë anëtarëve për komente para finalizimit.
6. Procesverbali ruhet në Arkivin e Akademisë.

### **Neni 19 Raportimi**

Këshilli i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor të punës jo më vonë se më 31 mars të vitit vijues.

### **DISPOZITAT KALIMTARE**

#### **Neni 20 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen të gjitha dispozitat tjera nënligjore që rregullojnë punën dhe funksionimin e Këshillit.

#### **Neni 21 Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas mënyrës së nxjerrjes së saj.


#### **Neni 22 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli.

Prishtinë, 01.06.2017



Aleksandër Lumezi

  
Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë